



NEON A.S
RR.XHANFISE KEKO, Nd.168 , H.1, CP. 1005
TIRANA, ALBANIA
TEL: +355 42 377 773 FAX: +355 42 347 770
E-MAIL: info@neon.al WEB: www.neon.al

NEON CHASSICOAT PROFFESIONAL (BOJË PROFESIONALE PER SHASI MAKINE)

Skedë Teknike

PËRSHKRIMI: NEON CHASSICOAT PROFFESIONAL është një bojë e bazuar në solventë e cila thahet shumë shpejt dhe përdoret për ruajtjen e shasisë së makinerive dhe paisjeve të tjera metalike. Ka veti mjaft të mira adezive dhe elasticitet të lartë. Ai shfaq rezistencë të lartë ndaj cimentosjeve, goditjeve, lagështisë dhe karburanteve.

FUSHA E PËRDORIMIT: NEON ANTIRUST PROFFESIONAL përdoret për lyerjen e shasive të makinerive.

NGJYRA: E zezë dhe kafe.

PARAPËRGATITJA: Sipërfaqja që do të bojatset, duhet të pastrohet nga pluhurat, yndyrnat apo nga shtresa të mëparshme të bojës apo të ndryshkut, të lidhura dobët me sipërfaqet, duke e pastruar me leter zmerile të përshtashme.

PËRDORIMI: Përgatitet boja duke e holluar fillimisht me diluent NC – 10.00 ose NX – 20. 000 ose White Spirit “NEON” NW – 13.30 në sasi 10 % ÷ 20 %, për të përfutur një bojë të gatshme e cila të punohet relativisht lehtë me penel, rrul ose pistoletë dhe të mos rrjedhë në sipërfaqet vertikale.

KUJDES: Nuk lejohet aplikimi i bojës në sipërfaqe të njoma dhe dhe të pa pastruara paraprakisht. Gjatë aplikimit të përdoren doreza të përshtatshme pune për të evituar kontaktin e bojës me lëkurën, si dhe në rastin e përdorimit të pistoletës duhet përdorur maskë mbrojtëse për organet e frymëmarrjes. Në rast kontakti me sytë, duhet bërë shpërlarja e tyre me ujë të bollshëm dhe të kërkohet ndihmë mjeksore. Nuk rekomandohet përdorimi i bojës në temperaturë më të vogël se 5°C. Pas përfundimit të lyerjes paisjet duhet të lahen menjëherë me white spirit.

TE DHENAT TEKNIKE:

- Ngjyra.....e zezë, kafe
- Imtësia.....5 – 40 µm
- Viskoziteti Dëp Cup 4.....150 – 200 sek
- Densiteti.....1.19 – 1.24 g/ml
- Fuqia mbuluese për lyerje të plotë.....12 – 14 m²/L
- Koha e tharjes.....2 – 4 orë

REZIKSHMËRIA: Bojrat CHASSICOAT janë të djekshme (R10), të dëmshme po të nuhaten (R20), irritojnë lëkurën (R38) si dhe duhet të ruhen larg fëmijëve (S 2), në

vënde të ajrosura mirë (S 9) dhe larg burimeve të zjarrit (S 16). Po kështu, mbeturinat e bojës nuk duhen derdhur në kanalet e shkarkimit (S 29) dhe ambalazhet e përdorura duhen hedhur në vënde të sigurta (S 35).

AMBALAZHIMI: Ambalazhimi bëhet në kuti metalike 0.75L.